

**AGJENCIA SHETETËRORE E PROKURIMEVE TË PËRQËNDRUARA**

Për: “NRG” SHPK

Adresa: Farke Selite Rruga: “Eduard Mano”, Pallati 10, Tiranë.

\* \* \*

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”- Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara,

me objekt: Loti 4 "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës",

me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzetë e katër) muaj, dhe

me fond të marrëveshjes kuadër: 15,479,671 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) Lekë (pa TVSH), ose Euro 137,842 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e dy) Euro,

me numër reference të Lotit 4: REF-66559-04-19-2023.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”- Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara,

me objekt: Loti 4 "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës",

me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzetë e katër) muaj,

dhe me fond të marrëveshjes kuadër: 15,479,671 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) Lekë (pa TVSH), ose Euro 137,842 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e dy) Euro,  
me numër reference të Lotit 4: REF-66559-04-19-2023.

Publikime të mëparshme ( jo ): Buletini i Njoftimeve Publike 03.07.2023, Nr. 60.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1) “FLORFARMA” SHPK K21405001N  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it  
Vlera: 10,055,023.2720 (dhjetë milion e pesëdhjetë e pesë mijë e njëzet e tre pikë dymijë e shtatëqind e njëzet) lekë (pa TVSH);  
(me numra dhe fjalë)

2)“Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” SHPK  
L04803001U Emri i plotë i shoqërisë  
numri i NIPT-it  
Vlera: 10,800,000 (dhjetë milion e tetëqind mijë) lekë (pa TVSH)  
(me numra dhe fjalë)

3) BOE “EGIAN MED” SHPK dhe “Vlera” SHPK L71715003C dhe 810198772  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera: 12,389,232 (dymbëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e dy ) lekë (pa TVSH);  
(me numra dhe fjalë)

4) BOE “AFA GRUP” SHPK dhe DU&KO SHPK L01502501H dhe K38207309W  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it  
Vlera: 13,899,864 (trembëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë (pa TVSH);  
(me numra dhe fjalë)

5) “NRG” SHPK L13426006B  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it  
Vlera: 14,640,768 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë (pa TVSH).  
(me numra dhe fjalë)

Për këtë procedurë prokurimi janë skualifikuar operatorët ekonomik: “AFA GRUP” SHPK; “EGIAN MED” SHPK dhe “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” SHPK për arsyet si vijon:

**OPERATORI BOE “AFA GRUP” SHPK dhe DU&KO SHPK:**

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik , nuk plotëson kushtet në zbatim të nenit 88 pika 1 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi në Marrëveshjen e Bashkëpunimit palët nuk kanë përcaktuar pjesën e furnizimit zërat konkretë të ofertës që do të kryejë secili nga anëtarët e BOE. Deklarimi i përqindjeve e pjesëmarrjes në furnizim në masën 51% AFA GRUP dhe DU& CO 49% në kontratën e bashkëpunimit, nuk përmbush kushtin e dispozitës nënligjore pasi pika 1 e Nenit 88 të VKM 285 kërkon shprehimisht ndarja e zërave të furnizimit për secilin operator duhet të përfshihet në kontratën e BOE ku citojmë se : Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

-Operatori ekonomik nuk plotësojnë kërkesat sipas Pikës 4 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit në DST, pasi nuk paraqiti asnjë dokument në lidhje me skedat teknike MDS specifikimet teknike për produktet biocide dhe jo biocide. Për këtë pikë është paraqitur e një produkti e cila nuk përbën në asnjë rast dokumentet ligjore të kërkuar në DST

**OPERATORI BOE “EGIAN MED” SHPK dhe “Vlera” SHPK:**

- Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas Pikës 1 Seksioni 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023, pasi operatori "VLERA" sh.p.k pajisut me NIPT nga organet tatimore në Kosovë me nr. 81OI98772 nuk ka paraqitur Liçencën për kategorinë II.8.B. Në zbatim të nenit 88, të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, kushti për licensën është i detyrueshëm për secilin nga antarët e bashkimit të operatorëve pasi kapacitetet teknike duhet të vërtetohen nga secili antar në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim. Gjithashtu operatori i huaj në këtë rast VLERA sh.p.k nuk mund të kryejë shërbime të dezinsketimit në territorin e Republikës së Shqipërisë me licensën e lëshuar në Kosovë por detyrimisht duhet të ishte paisur me Liçencën për kategorinë II.8.B, sipas shtojcës 1 te DST dhe Legjislacionit në fuqi, përpara paraqitjes të ofertës në formën e bashkimit të OE.

- Nga bashkimi i operatorëve “EGIAN MED” sh.p.k dhe "VLERA" sh.p.k në Kontratën e Bashkëpunimit midis operatorëve është deklaruar ndarja e punëve përkatësisht: "VLERA" sh.p.k merr përsipër 39% të punëve dhe “EGIAN MED” sh.p.k 63% të punëve. Ndërkohë në zërat e vlerave të deklarauara në tabelën e ndarjes së punëve, shifrat e deklarauara nga përfitimi i ndarjes së punëve sipas zërave janë të ndryshme nga ajo e deklaruar nga kontrata e bashkëpunimit, pasi rezulton se "VLERA" sh.p.k do të kryjë 27% të ofertës dhe “EGIAN MED” sh.p.k të 73% ofertës. Në zbatim të paragrafit të fundit të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim “rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim” ky mosrakordim i shifrave ne % (përqindje) I ndarjes së punëve në lidhje me objektin e prokurimit, përbën aryes për skualifikim te ketij bashkimi operatorësh.

**OPERATORI “Rruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” SHPK:**

-Ofertuesi nuk plotëson pikën 1, të seksionit 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023. OE nuk ka paraqitur Liçencën për kategorinë II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Bisnesit.

-Ofertuesi nuk nuk plotëson pikën 2.3 të seksionit 2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, pasi nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit të lotit 3.

-Ofertuesi nuk plotëson pikën 4, të seksionit 2.1 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit në DST, sipas shtojcës 1 dt.01.06.2023. pasi OE nuk ka paraqitur asnjë produkt biocid ose jobiocid si dhe kataloget /skedat teknike dhe dokumentacionin e të dhenave të sigurisë.

Operatori ekonomik “FLORFARMA” SHPK:

Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.875/2023 datë 04.09.2023, Operatori Ekonomik nuk plotëson Kërkesat mbi specifikimet teknike të produkteve sipas Shtojcës 5 të DST kreu II Llojet e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave dhe specifikimet teknike sipas habitateve “për këto asrye:

Produkti AQUATAIN me lëndë aktive Polidimetil siloksan (silicon), nuk përmbush specifikimet teknike për kryerjen e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave sipas habitateve të kategorisë “A”.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik “NRG” SHPK me NIPT L13426006B, me ofertë ekonomike me vlerë: 14,640,768 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, me adresë: Farke Selite Rruga: “Eduard Mano”, Pallati 10, Tiranë, të procedurës së prokurimit me objekt: Loti 4 "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës", me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzetë e katër) muaj, dhe me fond të marrëveshjes kuadër: 15,479,671 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) Lekë (pa TVSH), ose Euro 137,842 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e dy) Euro, me numër reference të Lotit 4: REF-66559-04-19-2023.

Njoftimi i Klasifikimit pas procesit të ri-vlerësimit është bërë në datë 18.09.2023.

Ankesa për dokumentat e tenderit: Po

Ankesa e operatorit ekonomik “NRG” SHPK protokolluar me tonën nr.615 prot., datë 26.04.2023, marrë përgjigje me Vendimin nr. 615/2 prot., datë 02.05.2023 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në Organin Qendror Blerës, si dhe Vendimin nr.399/2023, Vendimin nr.464/2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankesa për Vlerësimin e Ofertave: Po

Nga operatori ekonomik “EGIAN MED” SHPK dhe nga operatori ekonomik “NRG” SHPK, Marrë përgjigje me Vendimin nr.875/2023 datë 04.09.2023, si dhe Vendimin nr.949/2023 datë 22.09.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.